




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



PËR: Albina Shabani Rama, Kryetare në Gjykatën Themelore Prishtinë
NGA: Muhamet Rexha, Kryetar i Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore
LËNDA: Përgjigje
DATA: 25.09.2023



E nderuar Kryetare znj. Shabani Rama,

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, (me tutje si KKEGJ), me datë 16 gusht 2023, ka pranuar kërkesën tuaj me të cilën keni kërkuar dhënie të opinionit këshillëdhënës që të sqarohet dhe të vendoset një praktikë e konsoliduar gjyqësore për çështje disiplinore në rast kur ankesat i parashtrajnë personat të cilët nuk janë të përfshirë drejtpërdrejtë në çështjen për të cilën e parashtrajnë ankesë disiplinore.

Bazuar në nenin 1, 7 dhe 9 të Rregullores Nr.01/2022, për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, Komiteti ka shqyrtuar kërkesën tuaj në takimin e mbajtur me datë 19 shtator 2023.

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, KKEGJ ka arritur në përfundim se lidhur me çështjen e ngritur nga ana juaj nuk është e nevojshme të nxjerrët opinion këshillëdhënës, pasi që me nenin 9, paragrafi 1, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është përcaktuar qartë se kush ka të drejtë të paraqes ankesë ndaj gjyqtarëve, për sjellje të cilat vlerësohen të jenë në kundërshtim me rregullat e Kodit të Etikës. Në lidhje me këtë, dispozita e cekur më lartë shprehimisht parasheh se: “Personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari dhe prokurori lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek Autoritetet Kompetente”. Nga dispozita e cituar rrjedh se me ligj u është dhënë e drejta e ankesës ndaj një gjyqtari si personave fizik ashtu edhe personave juridik. Nga dispozita në fjalë çështje me rëndësi del të jetë fakti se sipas ligjit e drejta e parashtrimit të ankesës ndaj një gjyqtari nuk është e kushtëzuar me cilësinë e palës apo të ndonjë subjekti në procedurë. Pra ankesë mund të parashtrij secili person fizik dhe juridik ndaj cilit do gjyqtar pavarësisht nëse ankesi ka apo nuk ka një çështje në shqyrtim para gjyqtarit ndaj të cilit parashtron ankesë. Në lidhje me këtë, mundësia e ushtrimit të ankesës ndaj ndonjë gjyqtari pa u kushtëzuar me ekzistimin e çështjes së atij subjekti në gjykatë nga ligjdhënësi, ka pasur për qëllim që në këtë mënyrë kontrolli i publikut mbi punën e gjykatës të jetë më i gjerë, më i lehtë dhe i pakufizuar, e të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e shkeljeve të mundshme të rregullave të Kodit të Etikës dhe disiplinimit të gjyqtarëve për shkeljet e tilla.

Andaj, në përputhje me dispozitën e nenit 1 paragraf 2 të Rregullores Nr.01/2022, për Themelimin e KKEGJ, komiteti ju këshillon që Autoritetet Kompetente (kryetarët e gjykatave) bazuar nenin 9, paragrafi 1, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, janë të detyruar që të shqyrtojnë dhe të vendosin për të gjitha ankesat disiplinore të ushtruara nga personat fizik dhe juridik dhe atë në përputhje me dispozitën e nenit 9 paragraf 5 dhe 6 të po të njëjtit ligj.

Me respekt,